

VENDIM
Nr. 700, datë 21.8.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 815, DATË 29.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË BRENDSHME PËR GARDËN E REPUBLIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, e 10, 12, 13, 15/a të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga lista e inventarit të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës, reparti 322, Grupi Durrës që i bashkëlidhet vendimit nr. 815, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të sipërfaqes prej 33 838 (tridhjetë e tri mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) m², të ndodhur në zonën kadastrale 8518, Durrës.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha